

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-119/2014
GSK-KPA-A-121/2014**

Prishtinë/Priština, 1 Qershor 2016

Në çështjen juridike të:

Subjektit juridik **U. K. DOO**

Pala ankuese

Përfaqësues: A.Q. V., avokat, Prishtinë

kundër.

K. P.

Përfaqësues: N. H., avokat

Prishtinë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, si kryetar i kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anna Bednarek gjyqtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK) nr. KPCC/D/C/216/2013 të datës 21 gusht 2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA14328 dhe KPA14326), pas shqyrtimit të mbajtur më 1 Qershor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga U. K. DOO kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/216/2013, të datës 21 gusht 2013, në lidhje me kërkesat me numër KPA14328 dhe KPA14326 hedhen poshtë si të paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 10 tetor 2006, M. R. si përfaqësues i autorizuar i subjektit juridik U. K. DOO (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur dy kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP), me të cilën ka kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore, ri-posedim dhe kompensim për shfrytëzimin e kundërligjshëm të:
 - a) në njërën kërkesë të objekteve afariste (ndërtim i hapur/çati) të cilat gjenden në zonën ushtarake/depot e karburanteve në Han të Elezit (më parë i njohur si: Gjeneral Jankovic), në pikë kalimin kufitar në Kaçanik, me sipërfaqe prej 687 m²;
 - b) në kërkesën tjetër të objekteve afariste (pesë rezervuarë të çelikta mbi tokë) me sipërfaqe prej 250 m² në zonën ushtarake/depot e karburanteve në Han të Elezit (më parë i njohur si: Gjeneral Jankovic), në pikë kalimin kufitar në Kaçanik; (tani e tutje bashkë: pronat e kërkuara).
2. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1.a ishte regjistruar në AKP me numër KPA14328 dhe kërkesa nën 1.b ishte regjistruar me numër KPA14326.
3. Kërkesat KPA14328 dhe KPA14326 janë njoftuar më 6 shkurt 2009 duke vendosur njoftimin në pronat e kërkuara. Gjate notifikimit është gjetur se pronat e kërkuara ishin objekte afariste të zëna nga K. P. (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë). Pala përgjegjëse në ankesë ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje më 6 shkurt 2009 duke shpjeguar se pronat e kërkuara nuk ishin përdorur për banim dhe se e kishte të drejtën ligjore mbi to.
4. Pala përgjegjëse në ankesë po ashtu ka dorëzuar përgjigje ndaj kërkesave me pretendim se është duke e ushtruar të drejtën e tij ligjore të posedimit dhe të drejtën e shfrytëzimit të pronave të kërkuara.
5. Me vendimin e tij të 21 gushtit 2013 (KPCC/D/C/216/2013), KKPK ka vendosur t'i hedhë poshtë dy kërkesat me arsyetimin se kanë të bëjnë me pronë të luajtshme e jo me pronë private të paluajtshme dhe si të tilla bien jashtë juridiksionit të KKPK-së. Lidhur me kërkesat e palës

ankuese për kompensim, KKPK-ja ka këshilluar se kjo kërkesë mund t'i adresohet gjykatave kompetente vendore. Në faqen e fundit, vendimi i KKPK-së përmban këshillën lidhur me mundësinë e paraqitjes së ankesës brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të vendimit.

6. Më 20 dhjetor 2013, vendimi i KKPK-së mbi dy kërkesat i është dorëzuar palës ankuese. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 18 dhjetor 2013.
7. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së për kërkesën KPA14328 pranë Gjykatës Supreme të Kosovës më 31 janar 2014. Ai ka paraqitur ankesë të veçantë kundër vendimit të KKPK-së për kërkesën KPA14326 pranë Gjykatës Supreme të Kosovës më datë të njëjtë më 31 janar 2014. Gjykata Supreme ka regjistruar ankesën kundër kërkesës KPA14328 nën numrin 119/2014 dhe ankesën kundër kërkesës KPA14328 nën numrin 121/2014.
8. Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar kopjen e ankesave më 16 korrik 2014. Nuk është përgjigjur ndaj ankesave.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese në dy ankesat thekson se vendimi i kundërshtuar përmban gabime themelore në vlerësimin e kërkesës për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve të cilat kanë çuar në zbatim të gabuar të ligjit material. Prandaj, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin a apeluar dhe t'i pranojë si të bazuara kërkesat e paraqitura pranë AKP-së.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesat janë të paafatshme.
11. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, siç është ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079 (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*
12. Vendimet e KKPK-së i janë dorëzuar palës ankuese të premtën më 20 dhjetor 2013. Pra, afati kohor prej 30 ditësh ka përfunduar të dielën më 19 janar 2014, por është vazhduar deri të hënën më 20 janar 2014 në përputhje me nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/5 mbi

implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 në aneksin 1 të atij ligji.

13. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë më 31 janar 2014. Ai është këshilluar mjaftueshëm lidhur me afatin pasi që vendimi përmbante udhëzime lidhur me këtë afat.
14. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë arsye të vlefshme për këtë vonesë. Kjo do të thotë se ai ka paraqitur ankesë jashtë afatit kohor prej 30 ditësh.
15. Prandaj, ankesat duhet të hedhen poshtë për arsye procedurale si të paafatshme në pajtim me nenin 13.3 nën-paragrafin (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Këshillë juridike

16. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Anna Bednarek , Gjyqtare e EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it